



RAPORT NËNTËMUJOR I PUNËS

JANAR-SHTATOR 2022

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

 REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ORAOVCIT - OPŠTINA ORAOVAC
Drejtorja për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
Udhëheqja za Urbanizam, Planiranje i Zast. Sredine
225 N° 18.10-22
ORAOVCI - ORAOVAC

DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, ushtron përgjegjësitë që i ka Komuna sipas dispozitave ligjore nga lëmi i urbanizmit:

Harton planin e zhvillimit hapësinor, urbanistik dhe rural të Komunës, bënë përgatitjen dhe hartimin e akteve të përgjithshme normative të planifikimiturban dhe rural, bashkëpunon me institucionet e Komunës me rastin e përgatitjes dhe hartimit të planit hapësinor, urbanistik, planeve të rregullimit dhe planeve tjera, bënë planifikimin dhe zhvillimin hapësinor të Komunës, përcakton kushtet për rregullimin hapësinor, mban evidencat për emërtimet e vendbanimeve, rrugëve, shesheve si dhe numrate objekteve dhe shtëpive. bashkëpunon me Kuvendin e Komunës, Komitetin për urbanizëm dhe planifikimurban, kur ato trajtojnë çështjet nga lëmi i planifikimit hapësinor dhe urbanizmit, merr pjesë aktive në procedurat e planifikimit të hapësirës dhe rregullimit të tokës ndërtimore, planeve dhe programeve nga kjo lëmi, këshillon palët në procedurë dhe mënyrën e realizimit të të drejtave nga lëmi iurbanizmit, kryen dhe detyrat tjera nga fushëveprimi i vet dhe lëmi i rregullimit tëhapësirës, përpunon kërkesat për lëshimin e lejeve ndërtimore dhe përcakton kushteturbanistike për zbatimin e planit hapësinor, planin urbanistik, planet e rregullimit,planit të parcelimit, vijës së rregullimit dhe ndërtimit, lëshon lejet e ndërtimit, lejet e përdorimit dhe shfrytëzimit, cakton komisione përmbikëqyrjen të objekteve, jep pëlqimet e rregullimit të infrastrukturës, menaxhon projektet komunale të paraparë me buxhet nga lëmi i urbanizmit.

Në kuadër të Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit funksiononjë dy sektore,

Spektori i Urbanizmit dhe Planifikimit,

Spektori i Mbrojtjes së Mjedisit

Sektori i Urbanizmit dhe Planifikimit

Gjatë kësaj periudhe raportuse zyrtarët e DUPMM-së, nga sektori për Planifikim Urban janë angazhuar në letësimin e procedurave për aplikim e lejeve ndërtimore, leje të rrenimit, kushte ndërtimore, vërtetime etj.

Në sektorin e Urbanizmit dhe Planifikimit janë shqyrtuar:

Janar - Shtator 2022					
Kërkesat	Nr	Ap	Re	Sh	Hudhet
Leje ndertimi	37	30	1	4	1 Hudhet 1 Anuluar
Leje rrenimi	7	7			
Leje perdorimi	1	1			
Leje per ashensor	1		1		
Kushte nderimore	53	36	9	1	6 Hudhet 1 Anuluar
Shkrese	32	32			
Pelqim ndrimdestinim	58	43	4	10	1 Hudhet
Ankesa	3			3	
Reference	1	1			
Pranim teknik	1	1			
Gjithësejt	198	151	18	19	8 Hudhet 2 Anuluar
Lend te vitit 2021	6	3	3		

Të hyrat e përgjithëshme Janar - Shtator 2022

Parallogaria	21,183.54 €
Leje rrenimi	25 €
Vendim	20 €
Pelqime	2,920 €
<i>Totali të hyrave</i>	24,148.54 €

Legalizimi

Legalizimi si procesë ka përfunduar me 4 shtatore 2022. Aplikacionet që janë dorëzuar janë duke u shqyrtuar nga zyrtar për legalizim.

PARAQITJET E LEGALIZIMIT JANAR- SHTATOR / 2022						
Nr.	Nr protok.	Data e paraqitjes	Zona kat.	Funksioni	Kat.	Vendimi
1	47	11.01.2022	Rahohec	Banim+ Afarizem	I	Legalizim
2	48	11.01.2022	Rahohec	Banim+ Afarizem	I	Legalizim
3	60	11.01.2022	Kramovik	Banim	I	Legalizim
4	61	11.01.2022	Kramovik	Banim	I	Legalizim
5	62	11.01.2022	Kramovik	Banim	I	Legalizim
6	143	18.01.2022	Ratkoc	Banim	I	Legalizim
7	311	28.01.2022	Xërxë	Banim	I	Legalizim
8	312	28.01.2022	Xërxë	Banim	I	Legalizim
9	313	28.01.2022	Xërxë	Banim	I	Legalizim
10	314	28.01.2022	Bellacerkë	Banim	I	Njoftim
11	315	28.01.2022	Bellacerkë	Banim	I	Njoftim
12	493	18.02.2022	Rahovec	Banim	I	Legalizim
13	860	16.03.2022	Rahovec	Banim	I	Legalizim
14	861	16.03.2022	Rahovec	Banim	I	Legalizim
15	848	09.03.2022	Rahovec	Banim	I	Listë të pritjes
16	1176	05.04.2022	Rahovec	Banim	I	Legalizim
17	1211	06.04.2022	Rahovec	Banim+ Afarizem	I	Listë të pritjes
18	1241	08.04.2022	Rahovec	Banim	I	Proces
19	1410	26.04.2022	Rahovec	Banim	I	Legalizim
20	1441	28.04.2022	Rahovec	Banim	I	Njoftim
21	1514	05.05.2022	Rahovec	Banim	I	Legalizim
22	1547	06.05.2022	Rahovec	Afarizëm	II	Legalizim
23	1686	16.05.2022	Rahovec	Banim	I	Legalizim
24	1736	18.05.2022	Rahovec	Banim	I	Legalizim
25	1737	18.05.2022	Rahovec	Banim	I	Legalizim

26	2195	20.06.2022	Krushë e Madhe	Banim	I	Legalizim
27	2254	27.06.2022	Rahovec	Banim	I	Legalizim
28	2277	28.06.2022	Ratkoc	Banim	II	Legalizim
29	2293	29.06.2022	Rahovec	Banim	I	Legalizim
30	2610	22.07.2022	Rahovec	Banim me shumë njësi	II	Legalizim
31	2575	26.07.2022	Rahovec	Banim	I	Legalizim
32	2576	26.07.2022	Hoçë e vogël	Banim	I	Listë të pritjes
33	2759	02.08.2022	Xërxë	Banim	I	Legalizim
34	2760	02.08.2022	Xërxë	Banim	I	Legalizim
35	2761	02.08.2022	Xërxë	Banim	I	Legalizim
36	2864	09.08.2022	Ratkoc	Garazh	I	Legalizim
37	2865	09.08.2022	Ratkoc	Banim	I	Legalizim
38	2853	09.08.2022	Prizren	Banim	I	Listë të pritjes
39	2866	09.08.2022	Rahovec	Banim	II	Legalizim
40	2867	09.08.2022	Rahovec	Banim	I	Legalizim
41	2919	12.08.2022	Hoçë e Vogël	Banim	I	Listë të pritjes
42	2933	15.08.2022	Gexhë	Banim	I	Legalizim
43	2988	22.08.2022	Xërxë	Banim+ Afarizëm	II	Legalizim
44	3006	22.08.2022	Rahovec	Banim+ Afarizëm	II	Legalizim
45	3007	22.08.2022	Ratkoc	Banim	II	Legalizim
46	3018	22.08.2022	Brestoc	Banim	I	Listë të pritjes
47	3019	22.08.2022	Brestoc	Banim	II	Listë të pritjes
48	3028	22.08.2022	Xërxë	Banim	II	Listë të pritjes
49	4017	31.08.2022	Bellacerkë	Banim	I	Legalizim
50	4018	31.08.2022	Bellacerkë	Banim	I	Legalizim
51	4019	31.08.2022	Xërxë	Banim	I	Listë të pritjes
52	4020	31.08.2022	Xërxë	Banimi	I	Listë të pritjes
53	4021	31.08.2022	Xërxë	Banimi	I	Listë të pritjes
54	4022	31.08.2022	Bellacerkë	Banim	I	Legalizim
55	4023	31.08.2022	Bellacerkë	Banim	I	Legalizim
56	4024	31.08.2022	Xërxë	Banimi	I	Listë të pritjes
57	3093	31.08.2022	Rahovec	Banimi	I	Legalizim
58	3094	31.08.2022	Rahovec	Banimi	I	Legalizim

Sektori i Mjedisit

Në baze të Sektorit të mjedisit leshojm Leje mjedisore Komunale dhe Leje Ujore Komunale.

Me datën 24.01.2022 mbajtur takimin me JICA Japoneze, qellimi i takimit është diskutimi i detajeve të pilot projekteve për komunën Rahovecit si dhe aspektet ndërlidhse të përbashkëta për 4 komunitet e projektit me Jica Japoneze.

Në sektorin e Mjedisit janë shqyrtuar:

Data	Vlera
06.01.2022-20.01.2022	Njoftim
09.02.2022	96 EURO
04.02.2022	50 EURO
25.03.2022	50 euro
24.04.2022	Hudhet poshtë
08.06.2022	50 euro
10.05.2022	50 euro
13.06.2022	70 euro
13.06.2022	860 euro
08.06.2022	50 euro
24.06.2022	2500
15.07.2022	50 euro
25.07.2022	50
04.08.2022	100.80
20.09.2022	Aprovuar
	3976.80 EURO

Aktivitetet në periudhën janar-shtator:

- Plani Zhvillimor Komunal është dorëzuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastrukturës për pëlqim, pas marrjes së pëlqimit nga ministria dhe kuvendi komunal do dërgohet në diskutim publikë.
- Me 24 marsë, bashkë me drejtorin e Drejtorisë të Shërbimeve Publik, Përparim Krasniqi pritëm takim zyrtarë nga KEDS, biseduam rreth: Planifikimit të planit investiv 5 vjeçar 2022-2027.
- Me moton “Rahoveci, vend i pastër dhe ekologjik”, u shënuam ‘DITËN E TOKËS’, e cila na kujton rëndësinë vitale të mjedisit ku jetojmë, na troket në ndërgjegjen tonë dhe na rikujton detyrën që ta ruajmë: AJRIN, UJIN dhe TOKËN. “DITA E TOKËS” në Rahovec, u shënuar me disa veprime të thjeshta që mund të bëjmë çdo ditë për një Tokë më të mirë si: mbjellja e luleve sezonale në qytetin e Rahovecit dhe në fshatra, pastrimi vullnetar i disa rrugëve në qytet - nga oborri i Komunës e deri te varrezat e dëshmorëve, pastrimi i mjediseve përreth objekteve shkollore, eliminimi i deponive ilegale etj. Në kohën kur çështjet ambientaliste vetëm sa bëhen më të rëndësishme për shkak të ndotjes masive e të madhe të tokës, aktivitete të tilla nevojiten të bëhen sa më të shpeshta dhe mos të jenë vetëm të karakterit ceremonial. Gjeneratat e ardhshme do ta kenë më lehtë, nëse ne sot kujdesemi për planetin tonë, duke u nisur secili nga vendi ku jetojmë. Pjesë e këtij aksioni vullnetar ishin: DUPMM, DKA, DSHP, DSHPs, DKRS, DPI, SHL KOSOVA, nxënës dhe mësimsdhënës të të gjitha shkollave, Stacioni Policor në Rahovec, EKO-REGJIONI, EKO-DRINIA, BERISHA dhe akterë të tjerë, të cilët i falënderoj për angazhimin!
- Ndërtimi i shtratit të përroit në lagjen Kelmend në Kramovik-Punimet janë duke vazhduar në lagjen Kelmendi në Kramovik, ka përfunduar vendosja e gypave të ujrave të zeza, është duke u punuar me veshjen e shtratit me gurë. Rregullimi i shtratit të këtij përroi eviton vërshimet e shpeshta në këtë lagje, por edhe në fshat.
- Në Malësi të Vogël, zbuluam bustin e dëshmorit të kombit, Skender Kastrati në oborrin e shkollës që mban emrin e tij.
- Me 3 qershor është përfunduar Shtëpia- Muze në Mrasor dhe zbulimi i bustit të Heroit të Kombit, Skënder Rexhepi.
- Me rastin e 5 Qershorit – Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit shpalli konkursë publikë për:
 - Kopshtin më të rregulluar dhe me llojllojshmëri të florës,
 - Rruga më e pastër dhe më ekologjike
 - Ekologu i vitit 2022 (nga nxënës e klasave të gjashta Ekologji dhe Mjedis)
- Për nder të 14 Qeshorit, Ditës së Çlirimit të Rahovecit, në varrezat e dëshmorëve në Rahovec janë mbjellur 14 drunjt duke asocjuar me datën e çlirimit të komunës së Rahovecit.
- Me 23 korrik u shpalos pllaka përkujtimore për dëshmorët e atdheut, Gëzim Mullabazi, Samir Nurkasa, Xhafer Nurkasa dhe Xhevat Kasapi te vendi i rënies.

- Me 29 korrik u nënshkrua marveshja me ministrin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, z. Elbert Krasniqi, për mbështetjen financiare të projektit “Trajtimi i vlerave të trashëgimis kulturore dhe krijimin e sigurisë në qytetin e Rahovecit”.
- Në kontratën ndërtimi i parqeve në komunën e Rahovecit, ka filluar ndërtimi i parqeve në fshatrat Krushë e Madhe dhe Ratkovc.
- Është pastru një pjesa e shtratit të lumit Rimnik në Fortes.
- Në shtratin e lumit në Krushë të Madhe, ka filluar pastrimi i shtratit deri në Drin.